



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 17, shkronja h) të Ligjit NR.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHTI:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10)
NË GJIMNAZE DHE INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL (IAAP)
PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Nr.	Shkolla	Nr.i paral.	Nr. i nx.	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	Gjimnazi "Sami Frashëri"	10	28	Gjimnaz i shkencave natyrore	280
	Mësimi në gjuhën turke	1	28	Gjim. i shk. natyrore/në gj. turke/	28
	Gjithsej	11	28		308
2	Gjimnazi "Ahmet Gashi"	10	28	Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore	280
	Gjithsej	10	28		280
3	Gjimnazi "Matematik i specializuar"	2	25	Gjimnaz i shkencave matematikore	50
	Gjithsej	2	25		50
4	Gjimnazi "Xhevdet Doda"	11	28	Gjimnaz i shkencave natyrore	308
	Gjithsej	11	28		308
5	Gjimnazi "Eqrem Çabej"	6	28	Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore	168
	Gjithsej	6	28		168

6	Medreseja Alauddin			Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore	
		3	28	Prishtinë (djem)	84
		2	28	Prishtinë (vajza)	56
	Gjithsej	5	28		140
7	SHMM "Dr. Ali Sokoli"				
		3	28	Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë	84
		1	28	Teknik i fizioterapisë	28
		1	28	Teknik dentar	28
		1	28	Teknik i farmacisë	28
	<i>Gj. Boshnjake</i>	1	28	Teknik i farmacisë	28
	Gjithsej	7	28		196
8	SHMT "28 Nëntori"				
		1	26	Ndërtimtari	26
		1	26	Murator	26
		3	26	Arkitekturë	78
		1	26	Gjeodezi	26
		1	26	PTT	26
		1	26	Grafikë e shtypit	26
		1	26	Grafikë me libërlidhje	26
		1	26	Grafikë e mediave	26
	Gjithsej	10	26		260
9	SHMEJ "Hoxhë K. Prishtina"				
		3	26	Drejtimi: Ekonomi; Profili: Kontabilitet dhe tatime	78
		3	26	Drejtimi: Ekonomi; Profili: Banka, Financa dhe Sigurime	78
		1	26	Drejtimi: Ekonomi; Profili: Marketing dhe Shitje	26
		1	26	Drejtimi: Ekonomi; Profili: Shpëditer dhe Logjistikë	26
		4	26	Drejtimi: Administratë; Profili: Juridik, administratë dhe shërbime të zyrës	104
	Gjithsej	12	26		312
10	SHMHT "7 Shtatori"				
		2	26	Ekonomi-tregtar me shumicë dhe pakicë	52

		2	26	Hoteleri-kuzhinier	52
		2	26	Hoteleri-Asistent i mikpritjes hoteliere	52
		2	26	Turizëm-asistenti i turizmit dhe udhëtimeve	52
	Gjithsej	8	26		208
11	SHMAT "Abdyl Frashëri"				
		1	26	Bujqësi - Agrobiznes	26
		1	26	Bujqësi - Hortikulturë	26
		1	26	Mbrojtje e bimëve	26
		2	26	Teknologji ushqimore - Perpunues i ushqimit dhe profesionet e ngjashme	52
		1	26	Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	26
		1	26	Veterinë - Veterinari	26
	Gjithsej	7	26		182
12	SHME "Gjin Gazulli"				
		1	24	Teknik i Informatikës së Biznesit	24
		1	24	Teknik për Dizajnimin e Mediave Interaktive	24
		3	24	Zhvillues i Aplikacionit Softuerike	48
		1	24	Teknik i Sistemeve të TIK	24
		1	24	Teknik i Elektronikës	24
		1	24	Telekomunikacion	24
		2	24	Teknik i Energjetikës	48
		1	24	Instalues Elektrik	24
	Gjithsej	11	24		264
13	SHMM "Prenk Jakova"				
		1	25	Instrumental	25
		1	25	Bashkëpunëtor muzikor	25
	Gjithsej	2	25		50
	Total	102			2726

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë nxënësit të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm në komunën e Prishtinës (përfshirë në Gjimnazin e specializuar matematikor dhe në ato drejtime në shkollat profesionale të cilat janë mungesë në komunat tjera), dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Prishtinës.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën/Ekstraktin e lindjes. *(Janë të vlefshme edhe dokumentet e platformës e-kosova)*

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP (Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional) për vitin shkollor 2024/2025, bëhet me datat **10, 11 dhe 12 korrik 2024** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **13.07.2024**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **15.07.2024**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | | |
|-----------------------------------------------------------|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100 %) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga sukseksi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e suksesit të përgjithshëm është:

$$\text{Suksesi (kl.6+kl.7+kl.8+kl.9) } \times 2 = 40 \text{ pikë max.}$$

2. Nxënësi nga sukseksi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës(I) + mesatarja e lëndës(II) + mesatarja e lëndës(III) + mesatarja e lëndës(IV)} \\ = 20 \text{ pikë max.}$$

Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:

- a) Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë.
- b) Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi.

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- a) **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji ushqimore dhe Veterinari:**
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi;
- b) **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi-Teknologji, PTT:**
Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- c) **Ekonomi, administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi;
- d) **Juridik, Administratë:**
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi;
- e) **Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi;
- f) **Shkollat Artistike:**
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë;
Drejtimi pedagogjik- profili bashkëpunëtor muzikor:
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;
Drejtimi instrumental:
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë duhet t' i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

4. **Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:**

. **Gjimnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve:** fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes (Fizikë)} + \text{mes(Matematikë)}}{4} \geq 4$$

. Gjinnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (40 pikë nga lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

$$\frac{\text{mes(Gjuhë shqipe)} + \text{mes(Gjuhë angleze)} + \text{mes(Histori)} + \text{mes(Gjeografi)}}{4} \geq 4$$

. Shkollat e Shëndetësisë -Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët: fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes(Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

- | | | |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe | 35 pikë | |
| 2. Gjuhë angleze | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

II. Shkencat shoqërore:

- | | | |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 25 pikë | |
| 2. Histori | 25 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

III. Matematikë

- | | | |
|----------------|---------|--------------------|
| 1. Matematikë | 35 pikë | |
| 2. Informatikë | 15 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

IV. Shkencat natyrore:

- | | | |
|-------------|---------|--------------------|
| 1. Fizikë | 17 pikë | |
| 2. Kimi | 16 pikë | |
| 3. Biologji | 17 pikë | (Gjithsej 50 pikë) |

5. Renditja e lëndëve me përparësi në test sipas drejtimeve të gjinnazeve:

1. Gjinnazi shkencat e natyrës:

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Gjmnazi shoqëror dhe gjuhësor:

1. Shkenca shoqërore 50	50 X 0.3= 15 pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 X 0.3 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 50	50 x 0.15= 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

6. Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shkenca natyrore 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 50	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Shkenca natyrore 50	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

IV. Juridik

1. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 50	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 50	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 50	50 x 0.05 = 2.5 pikë
Totali = 40 pikë	

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze 50	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore 50	50 x 0.2 = 10 pikë

3. Matematikë dhe Informatikë 50
4. Shkenca natyrore 50

$50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

7. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar.

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII).

Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

8. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjimnazin e Specializuar Matematikor, për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë **vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm**, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Kandidatët që konkurrojnë kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9^e të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

I. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë Gjimnaz, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën e fotokopjuar për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9), nëse Konkursi shpallet në të njëjtën kohë me shkollat tjera-në të kundërtën paraqesin dëftesën origjinale dhe
- Certifikaten/Ekstraktin e lindjes. *(Janë të vlefshme edhe dokumentet e platformës e-kosova)*

II. Kriteret për regjistrim

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë– duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

- Provimi pranues përgatitet, kontrollohet nga mësimdhënës të Autorizuar nga shkolla.
- Kandidatët në rangim mund të arrijnë maksimalisht 100 pikë të shpërndara si vijon:
 1. Suksesi i Përgjithshëm nga Shkolla e mesme e ulët (20%), 20 pikë,
Për secilën nga klasat 6,7,8,9;
-Për sukses të Shkëlqyeshëm merr nga 5 pikë,
-Për sukses Shumë të mirë merr nga 4 pikë,

2. Suksessi nga Lënda e Matematikës në Shkollën e mesme të ulët maksimumi 20 pikë. Për secilën nga klasat 6,7,8,9.
 - Për notën 5 në Matematikë merr 5 pikë.
 - Për notën 4 në Matematikë merr 4 pikë.
3. Suksessi nga Testi i Arritshmërisë nga lënda e Matematikës maksimumi 20 pikë;
4. Suksessi i Provimit Pranues -maksimumi 40 pikë.

III. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnazin e specializuar matematikor, për vitin shkollor 2024/2025, bëhet prej datës **10, 11 dhe 12 korrik 2024** në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora 9.00-16.00.

Provimi pranues do të mbahet në lokalet e shkollës me datën **15.07.2024 në ora 12.00.**

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën **16.07.2024.**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **17.07.2024.**

Vërejtje: Nxënësi i refuzuar i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit, ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i parashtrijë ankesë drejtorisë së shkollës. Pas marrjes së përgjigjes nga shkolla brenda dy (2) ditë pune nxënësi ka të drejtë ankesë në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme Komisionit për ankesa në MASHTI.

Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) apo në MASHTI. DKA dhe MASHTI nuk shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.